



Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01 Nr. 06-2585/2015

Klinë, dt. 27.03/2015

Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 12.2 pika nen d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040, publikuar në gazetën zyrtare, Nr.28/2008, dispozitat e nenit 6 të U.A., Nr.2008/08 për Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, dispozitat e neni 5 të Rregullores, Nr.01-351-740/2015 për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Klinës, me qëllim të funksionalizimit të këtyre këshillave, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e vet të rregullt, të tretën me radhë për vitin 2015, të mbajtur, më dt.27.03/2015 mori, këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit për Zgjedhjen e Këshillave Lokale

- I. **FORMOHET**, Komisioni për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren, lidhur me zgjedhjen e këshillave lokale nëpër fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Klinës.

Përbërja e Komisionit është, si në vijim:

1. Ramush Agushi, anëtar i Kuvendit të Komunës;
 2. Enver Gashi, anëtar i Kuvendit të Komunës;
 3. Kristina Lazri, anëtar nga Ekzekutivi;
 4. Elbasan Raci, anëtar nga shoqëria civile;
 5. _____, përfaqësues i fshatit/lagjes _____.
- II. Përbërja e Komisionit duhet të përfaqësojë përbërjen e subjekteve politike me numër më të madh të anëtarëve të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës, ndërsa kryesuesi i komisionit zgjidhet nga anëtarët e komisionit.
- III. Komisioni duhet të bashkëpunojë në mënyrë që të organizojë zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale, i cili komision punën e vet e kryen në përputhje me rregullativën ligjore në bazë të U.A., Nr.2008/08 për Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, Rregullores, Nr. 01-351-740/2015 për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Klinës, si dhe akteve tjera pozitive.
- IV. Ky Vendim është i plotfuqishëm dhe hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përkatëse për vetëqeverisje lokale.
- V. Me Vendim të njoftohen: anëtarët e Komisionit, Ekzekutivi, MAPL-ja, Zyra Ligjore, Zyra për Punë të Kuvendit, si dhe Arkivi i Komunës.



Kryesuesi,
Dr. Haxhi Ibishi